



## **Përditësim për shtypin**

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, më 15 qershor Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesën e ekipit të Mbrojtjes së Fazliut për të zgatur afatin për dorëzimin e dosjes së saj përfundimtare, për shkak të problemeve të paparashikuara me personelin. Për të qenë i drejtë, Gjykatësi i Vetëm e zgjati afatin për të gjitha ekipet e Mbrojtjes dhe i urdhëroi të dorëzonin dosjet e tyre përfundimtare deri në 3 korrik, ose tri ditë pune pasi të jetë marrë vendim lidhur me një apel të ndërmjetëm të Prokurorisë. Në rast se faza e paraqitjes së provave nuk mund të mbyllet menjëherë pas daljes së vendimit mbi apelin e ndërmjetëm, palët do të konsultohen lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të procesit gjyqësor.

Kjo çështje gjyqësore është e gjashta që po gjykohet në Dhomat e Specializuara.

Çështja e parë gjyqësore e përfunduar ishte ajo e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt që u shpallën fajtorë për frikësim dhe vepra të tjera penale kundër administrimit të drejtësisë në maj 2022. Ata u liruan me kusht në vitin 2023 dhe e përfunduan dënimin në 2024.

Çështja e dytë gjyqësore e përfunduar ishte e Salih Mustafës, i cili në dhjetor 2022 u shpall fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe u urdhërua t'u paguajë zhdëmtim viktimave, që ishin të gjithë shqiptarë të Kosovës. Z. Mustafa u dënua fillimisht me 26 vjet burgim dhe apeli e uli dënimin në 15 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Çështja e tretë gjyqësore e përfunduar para Dhomave të Specializuara ishte ajo e Pjetër Shalës. Z. Shala u shpall fajtor në korrik 2024 për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe u urdhërua t'u paguante zhdëmtim viktimave, kryesisht shqiptarë të Kosovës. Z. Shala u dënua fillimisht me 18 vjet burgim dhe dënimi i tij u ul nga apeli në 13 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Çështja e katërt gjyqësore lidhej me pengimin e drejtësisë. Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala, u vetëdeklaruan fajtorë në dhjetor 2024 për veprën penale të frikësimit dhe vepra të tjera penale. Z. Januzi dhe z. Bahtijari u liruan me kusht në shkurt 2025 dhe përfunduan dënimin në tetor 2025. Haxhi Shala u lirua me kusht më 10 shkurt 2026 në vijim të modifikimit të dënimit të tij.

Së fundi, në një gjykim tjetër që është ende në proces, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi përballen me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ata janë vetëdeklaruar të pafajshëm lidhur me të gjitha akuzat. Faza e paraqitjes së provave është mbyllur dhe aktualisht Trupi Gjyqësor po kuvendon dhe do të lëshojë aktgjykimin në kohën e duhur.





Dhomat e Specializuara po vijojnë këtë javë me publikimin e një numri videosh shpjeguese “Vështrim mbi mandatin dhe punën e Dhomave të Specializuara.” Në videon e parë, Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova, shpjegon se si garantohet pavarësia, paanshmëria dhe profesionalizmi i gjykatësve. Videot e kësaj jave përmbajnë informacion më të hollësishëm lidhur me paraburgimin dhe lirin me kusht në DHSK, vizitat humanitare të të paraburgosurve në Kosovë dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë. Videot mund të gjenden në shqipe, anglishte dhe serbishte në faqen e internetit dhe profilet në mediat sociale të DHSK-së.

